



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 04, datë 19.10.2022

PËR
KONFISKIMIN PËR INTERES PUBLIK TË OBJEKTIT
“HOTEL 5 DHE 6 KAT, ME 2 KAT NËNTOKË”,
ME VENDNDODHJE NË RR. “QAMIL GURANJAKU”, BASHKIA TIRANË,
TË NDËRTUAR NË TEJKALIM TË LEJES SË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nënndarjes “iii” dhe “iv”, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, me propozim të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Konfiskimin për interes publik të objektit të miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.S-2440/6, datë 07.07.2020 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin “Hotel 5 dhe 6 kat, me 2 kat nëntokë”, me vendndodhje në Rr. “Qamil Guranjaku”, Bashkia Tiranë, me zhvillues shoqërinë “RT MAX” sh.p.k, i cili është ndërtuar në tejkalim të lejes së ndërtimit, në masën mbi 10 % të sipërfaqes ndërtimit mbi tokë.
2. Planvendosja e objektit të konfiskuar, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit të përcjellë këtë vendim pranë Ministrisë përgjegjëse në varësi të të cilës gjendet autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të konfiskuara të shtetit.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ose autoriteti i autorizuar prej saj të aplikojë nëpërmjet sistemit e-leje, për miratimin e një Leje Zhvillimi/Ndërtimi të re, si dhe lëshimin e Çertifikatës së Përdorimit, me qëllim rregullimin e pasojave të shkaktuara nga situata faktike, e krijuar nga ndërtimi në tejkalim të lejes së ndërtimit.
5. Pas miratimit të lejes përkatëse, Bashkia Tiranë të lëshojë certifikatën e përdorimit, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.



6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me certifikatën e përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
7. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ju njoftohet palëve.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I BRENDSHËM

BLDAR ÇUÇI



ANËTAR

MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

